



THIRRJE PËR APLIKIM

MBËSHTETJE FINANCIARE ME SUBVENCIONE PËR OJQ-të DHE SHOQATAT, QË ZHVILLOJNË AKTIVITETE NË FUSHËN E MIRËQENIES SOCIALE DHE OFROJNË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare me subvencione për OJQ-të dhe shoqatat, për zbatimin e projekteve për zhvillimin e aktiviteteve avokuese, këshilluese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.

Të gjithë organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe shoqatat të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, mund të aplikojnë me projekt-propozime për sigurimin e përkrahjes financiare me subvencione.

OJQ-të dhe shoqatat të cilat aplikojnë me projekt-propozim duhet të përcaktohen vetëm në një pikë. Projektet të cilat do të marrin përkrahje financiare, duhet të kanë për objekt zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e këtyre shërbimeve sociale dhe familjare:

- Shërbime ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara,
- Shërbime ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare,
- Shërbime dhe mbështetje me të mira materiale, për familjet që jetojnë në varfëri dhe kushte të rënda të banimit,
- Shërbime mbështetëse dhe trajtime psiko-sociale për fëmijët, gratë viktime të dhunës në familje dhe abuzime të ndryshme, si dhe mbështetja e grave për pavarësimin e tyre,
- Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara,
- Shërbime mbështetëse, sensibilizim dhe pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme rekreative për pensionistë dhe persona të moshuar.

Kualifikimi dhe dokumentet për aplikim

OJQ-të dhe shoqatat të cilat kërkojnë mbështetje me subvencione, duhet të janë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

OJQ-të dhe shoqatat duhet të ofrojnë dëshmi për projektet e realizuara në të kaluarën dhe kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Në projekt duhet të përshkruhet qartë qëllimi, objektivat, aktivitetet, përfituesit dhe buxheti.

Përshkrimi i kapaciteteve menaxhuese të organizatës, personelit dhe përfshirja e eksperteve në zbatimin e aktiviteteve të projektit.

OJQ-të dhe shoqatat, përveç dëshmive dhe kushteve për kualifikim, duhet të plotësojnë dhe bashkëngjisin këto dokumente për aplikim:

- Projekt-propozimi,
- Tabela e buxhetit të projektit,
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së apo shoqatës,
- Kopja e certifikatës së numrit fiskal,
- Kopja e Statutit të themelimit të OJQ-së apo shoqatës,
- Kopja e xhirollogarisë së OJQ-së apo shoqatës,
- Kopja e letërnjoftimit të Drejtorit Ekzekutiv të OJQ-së apo shoqatës,
- CV-të e stafit të angazhuar në zbatimin e projektit,
- Kopja e licencës për OJQ-të dhe shoqatat e licencuara nga MPMS-ja,
- Përparësi kanë OJQ-të dhe shoqatat të cilët janë të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale.

Afati dhe procedura e aplikimit

Afati për dorëzimin e projekt-propozimeve për mbështetje me subvencione do të jetë i hapur 15 ditë nga data e shpalljes. Projekt-propozimet me dokumentet e bashkëngjitura duhet të dorëzohen në zyrën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale në Rahovec, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00h, nga data 13.08.2020 – 27.08.2020. Për informata më të hollësishme mund të informoheni në zyrën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale në Rahovec.

Drejtori

Samir Mustafa

